



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE DHE E EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Nr. 987 Prot.

Tiranë, më 18/5 /2022

UDHËZIM

Nr. 04 datë 18/5 /2022

Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 04, dt. 28.03.2019 “Mbi zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv”

Ne zbatim të Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 252, datë 29.4.2022 Për procedurat e ofrimit të shërbimeve on-line nga institucionet shërbimofruese dhe për metodologjinë e monitorimit e të kontrollit të veprimtarisë administrative të ofrimit të tyre”, si dhe;

Më qëllim, lehtësimin e procedurave doganore lidhur me shërbimet e ofruara nga Administrata Doganore Shqiptare, Drejtori i Përgjithshëm i Doganave:

UDHËZON

Në Udhëzimin nr. 04, dt. 28.03.2019 “Mbi zbatimin praktik të Regjimit të Përpunimit Aktiv” bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në rubrikën VI - “Procedura të thjeshtuara” miratohen ndryshimet si vijon:

- Në pikën 1 hiqet shkronja “d) - Operacione për përpunim të mëtejshëm jashtë territorit shqiptar dhe rikthehen përsëri për përpunim përfundimtar”.
- Hiqet pika “5”, e cila paraqet procedurën për miratimin e autorizimit për Regjim të Përpunimit Pasiv të mallrave nën Regjimin e Përpunimit Aktiv të cilat eksportohen përkohësisht për të kryer një proces përpunimi”

2. Duke filluar nga data e miratimit të këtij ndryshimi në udhëzim, aplikimi për vendosjen e mallrave nën RPA në një Regjim Përpunimi Pasiv do të kryhet nëpërmjet portalit e-Albania në shërbimin “Aplikim për autorizimin e Regjimit të Përpunimit Pasiv”. Aplikimi për Regjimin e Përpunimit Pasiv të mallrave nën RPA shqyrtohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, e cila miraton dhe autorizimin për këtë regjim.

Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

DREJTORI PËRGJITHSHËM

Genti Guzheli